



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04/IA005

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 19 korrik 2022

**Gjuha e origjinalit:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin kundër Vendimit në lidhje me  
Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e  
Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës:**  
Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtësit të viktimave:**  
Sajmon Loz

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)<sup>1</sup> duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim një apel të parashtruar më 4 maj 2022 nga Pjetër Shala (përkatësisht “Apeli” dhe “Shala” ose “Mbrojtja”)<sup>2</sup> kundër “Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës” (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>3</sup> Më 16 maj 2022, ZPS-ja u përgjigj se Apeli duhej rrëzuar (“Përgjigjja”).<sup>4</sup> Shala u kundërpërgjigj më 23 maj 2022 (“Kundërpërgjigjja”).<sup>5</sup>

## I. HISTORIKU

1. Më 16 mars 2021, Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”),<sup>6</sup> në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake<sup>7</sup>, në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij.<sup>8</sup>

---

<sup>1</sup> IA005/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 6 maj 2022 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 19 korrik 2022).

<sup>2</sup> IA005/F00001, Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022, 4 maj 2022 (konfidencial) (“Apeli”).

<sup>3</sup> F00188/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës, 28 prill 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 22 prill 2022) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>4</sup> IA005/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj ‘Apelit të Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022’, 16 maj 2022 (konfidenciale) (“Përgjigjja”).

<sup>5</sup> IA005/F00004, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes ndaj Apelit kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022, 23 maj 2022 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigjja”).

<sup>6</sup> F00013, Njoftim i Arrestimit të Pjetër Shalës sipas Rregullës 55(4), 16 mars 2021 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 29 prill 2021).

<sup>7</sup> F00008/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Pjetër Shala, 15 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020, riklasifikuar si konfidencial më 19 tetor 2021).

<sup>8</sup> F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 6 maj 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020); shih gjithashtu F00010/A02, Aktakuza, 19 qershor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidenciale më 29 prill 2021). Aktakuza e korrigjuar, përkatësisht aktakuza në fuqi, u dorëzua nga

2. Më 15 prill 2021, Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“objekti i paraburgimit”) në Hagë, Holandë.<sup>9</sup>
3. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën për lirim të përkohshëm të Shalës (“Vendimi i Parë për Paraburgimin”),<sup>10</sup> me një vendim që u konfirmua nga Paneli i Gjykatës së Apelit më 20 gusht 2021 (“Vendimi i Parë i Apelit”).<sup>11</sup>
4. Më 10 shtator 2021, 10 nëntor 2021 dhe 28 janar 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e Shalës dhe urdhëroi vazhdimin e tij (përkatësisht, “Vendimi i Dytë për Paraburgimin”, “Vendimi i Tretë për Paraburgimin”, dhe “Vendimi i Katërt për Paraburgimin”).<sup>12</sup>

---

ZPS-ja më 1 nëntor 2021, mbi bazën e Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës. Shih F00098/A01, Aktakuza e Korrigjuar, 1 nëntor 2021 (konfidenciale); F00107/A01, Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Korrigjuar, 16 nëntor 2021. Shih gjithashtu F00089/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 18 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 tetor 2021).

<sup>9</sup> F00019/RED, Version i Redaktuar Publik i ‘Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit’, parashtrimi F00019 i datës 15 prill 2021, 26 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 prill 2021, riklasifikuar si konfidencial më 29 prill 2021), para. 2.

<sup>10</sup> F00045/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm, 23 qershor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 qershor 2021) (“Vendimi i Parë për Paraburgimin”); F00039/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit për Lirim të Përkohshëm, 17 qershor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 maj 2021).

<sup>11</sup> IA001/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2021) (“Vendimi i Parë i Apelit”); IA001/F00001/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes kundër “Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm”, 31 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 28 qershor 2021).

<sup>12</sup> F00075/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 10 shtator 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 shtator 2021) (“Vendimi i Dytë për Paraburgimin”); F00105/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 10 nëntor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 nëntor 2021) (“Vendimi i Tretë për Paraburgimin”); F00133/RED, Version i Redaktuar Publik i vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 28 janar 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 28 janar 2022) (“Vendimi i Katërt për Paraburgimin”).

5. Më 11 shkurt 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit nxori vendim mbi apelin e Shalës kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin (“Vendimi i Dytë i Apelit”),<sup>13</sup> në të cilin konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte keqpërdorur kompetencën e tij diskrecionale duke arritur në përfundimin se asnjë nga kushtet e propozuara nga Shala (“kushtet e propozuara”), dhe asnjë kusht shtesë, nuk mund të zvogëlonte rreziqet e evidentuara, pa e ftuar më parë Mbrojtjen të kërkonte informacion lidhur me gatishmërinë dhe kapacitetin e Belgjikës për të zbatuar kushte të tilla; dhe miratoi pjesërisht pikën e shtatë të apelit të Shalës që kishte të bënte me vlerësimin e kushteve të lirit.<sup>14</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit ia ktheu këtë çështje Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të (i) kërkuar informacion nga Administratorja në lidhje me regjimin e paraburgimit që zbatohet për Shalën në objektin e paraburgimit, (ii) ftuar Mbrojtjen që të kërkonte informacion nga autoritetet belge mbi gatishmërinë dhe kapacitetin e tyre për të zbatuar kushtet e propozuara ose çdo kusht shtesë, dhe (iii) vlerësuar nëse këto kushte mund të zvogëlonin rreziqet e evidentuara.<sup>15</sup>

---

<sup>13</sup> IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 11 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 shkurt 2022) (“Vendimi i Dytë i Apelit”); IA003/F00001/RED, Version i Redaktuar Publik i “Apelit të Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 10 nëntor 2021”, 21 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 22 nëntor 2021) (“Apeli i Dytë”).

<sup>14</sup> Vendimi i Dytë i Apelit, para. 56-58, 60-61.

<sup>15</sup> Vendimi i Dytë i Apelit, para. 54-58, 60-61. Vendimi i Dytë i Apelit u lëshua pas Vendimit të Katërt për Paraburgimin, pasi Shala bëri të ditur se nuk do të kërkonte një ndryshim të mëtejshëm të afatit, pas apelit të tij kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin. Shih F00125, Parashtrime sipas Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 14 dhjetor 2021, 16 dhjetor 2021, para. 2. Shih gjithashtu F00110, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshim të Afatit për Parashtrimet e Saj lidhur me Rishikimin e Ardhsëm të Paraburgimit të z. Shala, 18 nëntor 2021, para. 9.

6. Më 22 shkurt 2022, Administratorja, në vijim të urdhrimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>16</sup> dorëzoi parashtrime në lidhje me regjimin e paraburgimit në objektin e paraburgimit.<sup>17</sup>

7. Më 30 mars 2022, Shala dorëzoi parashtrimet e tij në lidhje me rishikimin e paraburgimit, në të cilat, ndër të tjera, bëri të ditur se në vijim të Vendimit të Dytë të Apelit dhe urdhrimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ai kishte kontaktuar, përmes Zyrës Administrative, autoritetet belge për të kërkuar informacion lidhur me gatishmërinë dhe kapacitetin e tyre për të zbatuar kushtet e propozuara dhe/ose çdo kusht tjetër shtesë.<sup>18</sup> Ai u informua nga Zyra Administrative se autoritetet belge ishin përgjigjur se [REDAKTUAR].<sup>19</sup> ZPS-ja u përgjigj më 7 prill 2022<sup>20</sup> dhe Shala u kundërpërgjigj më 12 prill 2022.<sup>21</sup>

---

<sup>16</sup> F00145, Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim Informacioni mbi Regjimin e Paraburgimit dhe për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 14 shkurt 2022, ("Urdhër për Parashtrime"), para. 9, 11; F00145/A01, Shtojcë e Urdhrit drejtuar Administratores për Dorëzim Informacioni mbi Regjimin e Paraburgimit dhe për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 14 shkurt 2022 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 21 prill 2022).

<sup>17</sup> F00152/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Zyrës Administrative në Përputhje me Urdhrin për Dorëzim Informacioni mbi Regjimin e Paraburgimit (F00145), parashtrimi F00152 i datës 22 shkurt 2022, 22 prill 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 22 shkurt 2022).

<sup>18</sup> F00171/RED, Version i Redaktuar Publik i "Parashtrimeve të Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit dhe Përgjigje ndaj Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake", 28 prill 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 mars 2022) ("Parashtrimet e Shalës"), para. 6. Më 14 shkurt 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, ftoi Shalën që të kërkonte informacion mbi gatishmërinë dhe kapacitetin e Belgjikës për të zbatuar të gjitha kushtet e lirit të propozuara dhe/ose çdo kusht tjetër dhe urdhëroi Shalën që jo më vonë se data 2 mars 2022, të dorëzonte parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të tij. Shih, Urdhri për Parashtrime, para. 10-11. Më 4 mars 2022, me kërkesë të Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia zgjati Shalës afatin për dorëzimin e parashtrimeve deri më 30 mars 2022. Shih Transkripti, 4 mars 2022, f. 189-190. Shih gjithashtu F00160, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimet për Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit, 1 mars 2022, para. 2, 8-11.

<sup>19</sup> Parashtrimet e Shalës, para. 6.

<sup>20</sup> F00177/RED, Version i Redaktuar Publik i 'Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit', KSC-BC-2020-04/F00177, të datës 7 prill 2022, 22 prill 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 7 prill 2022).

<sup>21</sup> F00184, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj 'Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit', 12 prill 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 25 prill 2022) ("Kundërpërgjigja e Shalës ndaj Parashtrimeve të ZPS-së").

8. Më 19 prill 2022, në vijim të urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>22</sup> Administratorja dorëzoi korrespondencën me autoritetet belge.<sup>23</sup>
9. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Kundërshtuar me të cilin konfirmoi Vendimin e Tretë për Paraburgimin të kthyer nga Paneli i Apelit dhe urdhëroi vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të Shalës, mbi bazën e, ndër të tjera, ekzistencës së dyshimit të bazuar se ai ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, dhe vazhdimin të ekzistencës së rrezikut që ai të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të Dhomave të Specializuara ose të kryejë krime të tjera ndaj atyre që konsiderohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndër të cilët ka dhe dëshmitarë të mundshëm.<sup>24</sup>
10. Në Apel Shala shtjellon pesë pika që kanë të bëjnë me pretendime për gabime ligjore dhe faktike dhe keqpërdorim të kompetencës diskrecionale nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>25</sup> Shala kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të miratojë Apelin dhe të urdhërojë lirimin e menjëhershëm ose vendosjen në arrest shtëpiak të tij, me çfarëdo kushti që të gjykohet i përshtatshëm.<sup>26</sup>

## II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

11. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të vendosur në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.<sup>27</sup>

---

<sup>22</sup> Transkripti, 14 prill 2022, f. 248-249, 296; F00185, Përcjellje e Korrespondencës, 19 prill 2022.

<sup>23</sup> F00185/A01, Shtojca 1 e Përcjelljes së Korrespondencës, 19 prill 2022 (konfidenciale); F00185/A02, Shtojca 2 e Përcjelljes së Korrespondencës, 19 prill 2022 (konfidenciale) ("Korrespondenca me Autoritetet Belge"). Në përgjigjen e tyre ndaj kërkesës së Shalës për informacion, autoritetet belge bënë të ditur se [REDAKTUAR]. Shih Korrespondenca me Autoritetet Belge, f. 2.

<sup>24</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 31, 35, 40, 42-43, 52, 59.

<sup>25</sup> Apeli, para. 3, 17-36.

<sup>26</sup> Apeli, para. 5, 37.

<sup>27</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi mbi Apelin e Gucatit"), para. 4-14. Shih gjithashtu Vendimi i Dytë i Apelit, para. 9.

### III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

12. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se Shala dhe ZPS-ja ende nuk kanë dorëzuar versionet e redaktuara publike të Apelit, Përgjigjes dhe Kundërpërgjigjes së tyre.<sup>28</sup> Duke pasur parasysh se të gjitha parashtrimet e paraqitura në Dhomat e Specializuara janë publike, përveç nëse ka arsye të jashtëzakonshme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët paraqesin versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve jopublike të dorëzuara Trupit Gjykues,<sup>29</sup> Paneli urdhëron palët që brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim, të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve të lartpërmendura.

13. Paneli inkurajon edhe një herë palët që të dorëzojnë sa më shpejt të jetë e mundur versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre, pa pritur një urdhër për ta bërë këtë.<sup>30</sup>

### IV. DISKUTIM

A. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME STANDARDIN E VËRTETIMIT QË ZBATOHEP PËR RISHIKIMIN E PARABURGIMIT (PIKA 1)

#### 1. Parashtrimet e palëve

14. Shala argumenton se ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi rëndësinë e zbatimit të standardit të duhur të vërtetimit, konkretisht se ZPS-ja ka detyrimin e provës dhe duhet të japë argumente dhe prova konkrete për të vërtetuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm në kohën kur kryhet rishikimi,<sup>31</sup> ai gaboi në zbatimin e këtij standardi gjatë vlerësimit të ekzistencës së rreziqeve sipas

<sup>28</sup> Paneli vëren se ZPS-ja në Përgjigjen e saj ka vënë në dukje se do të dorëzojë versionin e redaktuar publik, megjithatë, nuk e ka bërë ende këtë.

<sup>29</sup> Shih p.sh. Vendimi i Parë i Apelit, para. 6; Vendimi i Dytë i Apelit, para. 10.

<sup>30</sup> Shih Vendimi i Dytë i Apelit, poshtëshënimi 22, që i referohet KSC-BC-2020-06, IA008/F0004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 1 tetor 2021 (version konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i Dytë i Apelit të Veselit"), para. 9.

<sup>31</sup> Apeli, para. 18, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 25, 32.

nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>32</sup> Sipas Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri një vlerësim të plotë të parashtrimeve të Mbrojtjes dhe gaboi kur u mbështet tërësisht në faktorë të mëhershëm dhe në zhvillime të pashmangshme, ndërkohë që priste nga Mbrojtja që të dorëzonte parashtrime konkrete në lidhje me rrezikun e arratisjes, pengimit të procedurave dhe kryerjes së krimeve të tjera.<sup>33</sup>

15. Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi dhe ishte në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut kur rrëzoi argumentet e Mbrojtjes thjesht me arsyetimin se “ato tashmë janë trajtuar”, dhe u mbështet në një interpretim të gabuar të jurisprudencës së Panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>34</sup> Gjithashtu, Shala argumenton se duke e zhvendosur detyrimin e provës tek Mbrojtja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i mundësoi ZPS-së t’u shmangej detyrimeve të saj për të paraqitur e prova konkrete dhe provuar se arsyet për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë.<sup>35</sup>

16. ZPS-ja përgjigjet se Shala thjesht përsërit argumentet e pabaza që tashmë janë rrëzuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>36</sup> ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi standardin dhe detyrimin e duhur të vërtetimit,<sup>37</sup> se konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rrezikun që Shala të pengonte procedurat ose të kryente krime të tjera, bazohen në arsye konkrete dhe prova të shumta, dhe se Mbrojtja nuk kishte paraqitur “asnjë rrethanë që provonte zvogëlimin e rrezikut të faktuar”.<sup>38</sup> Sipas ZPS-së, Shala jo vetëm që keqinterpretoi Vendimin e Kundërshtuar,<sup>39</sup> por edhe shpërfilli faktin se Paneli i Gjykatës së Apelit tashmë kishte konfirmuar se

---

<sup>32</sup> Apeli, para. 18-19. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjja, para. 4.

<sup>33</sup> Apeli, para. 20, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 28, 34, 36, 41-42, 54. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjja, para. 6-7.

<sup>34</sup> Apeli, para. 22-24. Shih gjithashtu Apeli, para. 20; Kundërpërgjigjja, para. 5-6, 8.

<sup>35</sup> Apeli, para. 21-22, 25; Kundërpërgjigjja, para. 4, 6.

<sup>36</sup> Përgjigjja, para. 17. Shih gjithashtu Përgjigjja, para. 18, 23-25.

<sup>37</sup> Përgjigjja, para. 18-20, 23, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 25-26, 32.

<sup>38</sup> Përgjigjja, para. 20-22.

<sup>39</sup> Përgjigjja, para. 23, që i referohet Apelit, para. 20, i cili citon Vendimin e Kundërshtuar, para. 34, 36, 41.



qasja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”).<sup>40</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

17. Fillimisht, Paneli vëren se në Apel, Shala përsërit në masë të madhe argumentet e pasuksesshme të parashtruara Panelit më parë dhe të rrëzuara prej tij në Vendimin e Dytë të Apelit.<sup>41</sup> Sidoqoftë, Paneli do t’i trajtojë më poshtë këto argumente në kontekstin e Vendimit të Kundërshtuar.

18. Paneli thekson se, siç ka pranuar dhe Mbrojtja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi standardin dhe detyrimin e duhur të vërtetimit, konkretisht se ZPS-ja: (i) ka detyrimin të provojë se mbajtja në paraburgim e të akuzuarit është e domosdoshme; dhe (ii) duhet të japë argumente specifike dhe prova konkrete se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm në kohën kur kryhet rishikimi.<sup>42</sup>

19. Mbrojtja në thelb argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur zbatoi këtë standard në vlerësimin e tij për rreziqet sipas nenit 41(6)(b), duke pretenduar se ai ishte mbështetur tërësisht në faktorë të mëhershëm dhe zhvillime të pashmangshme, siç është përparimi i procedurave, ndërkohë që priste nga Mbrojtja (jo nga ZPS-ja) të dorëzonte parashtrime konkrete në lidhje me rreziqet.<sup>43</sup>

20. Paneli rikujton, siç është thënë saktë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>44</sup> se paneli kompetent ka për detyrë të shqyrtojë arsyet ose rrethanat që mbështesin paraburgimin dhe të përcaktojë nëse ato “ende ekzistojnë”, por nuk ka detyrimin të shqyrtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumente tashmë të trajtuara, ose të bëjë

---

<sup>40</sup> Përgjigjja, para. 24-25.

<sup>41</sup> Krahaso Apeli, para. 18-25 me Vendimin e Dytë të Apelit, para 15-20 dhe Apeli i Dytë, para. 15-21.

<sup>42</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para 25, 32; Apeli, para. 18. Shih gjithashtu Vendimi i Dytë i Apelit, para. 15; Vendimi i Parë i Apelit, para. 24, 41.

<sup>43</sup> Apeli, para. 19-25.

<sup>44</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 16, 25, 33.

konstatime lidhur me faktorë për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimet e mëhershme të tij.<sup>45</sup>

21. Në rastin konkret, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vënë posaçërisht në dukje se pas një shqyrtimi të plotë të faktorëve dhe rrethanave në të cilat janë mbështetur vendimet e mëparshme për paraburgimin, në kohën e rishikimit këta faktorë ende ekzistojnë.<sup>46</sup> Paneli gjithashtu thekson se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vlerësuar saktë se shumica e parashtrimeve të Shalës thjesht përsërisin argumentet tashmë të rrëzuara në vendimet e mëhershme dhe vendosi të mos i trajtojë më ato.<sup>47</sup> Gjithashtu, në kundërshtim me pretendimin e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në fakt ka trajtuar në mënyrë konkrete argumentet e tij në përgjigje të parashtrimeve të ZPS-së për rrezikun e pengimit të procedurave.<sup>48</sup> Për më tepër, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi me hollësi parashtrimet dhe provat e reja të paraqitura nga ZPS-ja, duke gjetur në disa raste mangësi në argumentet e ZPS-së.<sup>49</sup> Bazuar në sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Shala nuk ka provuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në zbatimin e standardit të duhur të vërtetimit gjatë rishikimit të vazhdimit të paraburgimit të Shalës. Rrjedhimisht, pika e parë e apelit të Shalës rrëzohet.

---

<sup>45</sup> Vendimi i Dytë i Apelit, para. 16-18; KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021, para. 55. Shih gjithashtu Neni 41(10) i Ligjit: “nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim”.

<sup>46</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35, 37, 42, 46, 47.

<sup>47</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 33, 34, 36, 41, 47. Shih Parashtrimet e Shalës, para. 16 (në të cilin Mbrojtja “thekson se u përmbahet plotësisht parashtrimeve të veta të mëparshme mbi paligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të z. Shala”), 22 (në të cilin Mbrojtja “përsërit parashtrimet e veta të bëra më parë në lidhje me rreziqet e pretenduara”), 24 (në të cilin Mbrojtja “i qëndron mendimit të vet se mund të zbatohen masa të përshtatshme”). Paneli thekson se pjesa tjetër e argumenteve të Shalës të parashtruara Gjykatësit të Procedurës Paraprake kryesisht kishin të bënin me standardin the detyrimin e vërtetimit. Shih Parashtrimet e Shalës, para. 17, 20-21; Kundërpërgjigjja e Shalës ndaj Parashtrimeve të ZPS-së, para. 3, 5, 7.

<sup>48</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 36, 38-40. *Contra* Apeli, para. 24.

<sup>49</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35, 46.

B. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E RREZIKUT TË ARRATISJES (PIKAT 2 DHE 3)

22. Paneli thekson se në pikën e dytë dhe të tretë të apelit të vet, Shala parashtron argumente që trajtojnë vetëm rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit.<sup>50</sup> Duke pasur parasysh se përfundimi i arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se paraburgimi i Shalës duhet të vazhdojë nuk është bazuar në konstatimet e tij lidhur me rrezikun e arratisjes,<sup>51</sup> Paneli rrëzon menjëherë pikën e dytë dhe të tretë të apelit të Shalës.<sup>52</sup>

C. GABIMET E PRETENDUARA NË LIDHJE ME STANDARDIN PËR LIRIM ME KUSHT (PIKA 4)

### 1. Parashtrimet e palëve

23. Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur vendosi një standard të pazbatueshëm për lirimin me kusht pas rishikimit të rregullt të paraburgimit.<sup>53</sup> Së pari, Shala argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në një masë të madhe në [REDAKTUAR] Shalës [REDAKTUAR] dhe në supozimin hamendësues se [REDAKTUAR].<sup>54</sup> Sipas Shalës, kjo, marrë së bashku me supozimin se ecuria e mëtejshme e procesit rrit vetvetiu rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit<sup>55</sup> dhe, për më tepër, se asnjë kusht i propozuar ose kusht shtesë nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet, “paracakton fatin e çdo vendimi për rishikimin e paraburgimit”.<sup>56</sup>

24. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi standardin e duhur për vlerësimin e ekzistencës së rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) dhe nuk

---

<sup>50</sup> Apeli, para. 26-30; Kundërpërgjigjja, para. 9-11.

<sup>51</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46, 52.

<sup>52</sup> Shih në mënyrë të ngjashme Vendimi i Parë i Apelit, para. 29; Vendimi i Dytë i Apelit, para. 21.

<sup>53</sup> Apeli, para. 17, 33.

<sup>54</sup> Apeli, para. 31-32, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 37-40.

<sup>55</sup> Apeli, para. 33.

<sup>56</sup> Apeli, para. 33.

“supozoi në mënyrë të palejueshme” se [REDAKTUAR].<sup>57</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shtjelloi qartë arsyet për konstatimin se ekzistonte një mundësi reale që Shala të pengonte ecurinë e procesit,<sup>58</sup> dhe se kjo ishte konfirmuar më parë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>59</sup> Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se, duke argumentuar se konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rreziqet sipas nenit 41(6)(b) paracaktojnë fatin e çdo vendimi, Shala keqinterpretonte kornizën ligjore për rishikimin e paraburgimit<sup>60</sup> dhe thjesht përsëritte argumentet e rrëzuara më parë nga Paneli.<sup>61</sup>

25. Shala kundërpërgjigjet se ZPS-ja sugjeron në mënyrë të pavërtetë se kjo pikë e apelit tashmë është rrëzuar nga Paneli, duke mos përcaktuar në cilin vendim. Shala argumenton se në fakt, Paneli e kishte gjykuar të “panevojshme” të shqyrtonte një pikë të ngjashme të apelit si rezultat i miratimit të pjesshëm të një pike tjetër të apelit.<sup>62</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

26. Paneli thekson se ndonëse Shala parashtron se ai kundërshton standardin e përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për lirimin me kusht, argumentet e Shalës në lidhje me këtë pikë kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rreziqet e pengimit të ecurisë së procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.<sup>63</sup>

27. Fillimisht, Paneli rikujton se standardi që duhet të zbatohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për vlerësimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të

---

<sup>57</sup> Përgjigjja, para. 36.

<sup>58</sup> Përgjigjja, para. 37, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 37-40.

<sup>59</sup> Përgjigjja, para. 37, që i referohet Vendimit të Dytë të Apelit, para. 33, 38.

<sup>60</sup> Përgjigjja, para. 38, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 25, 55.

<sup>61</sup> Përgjigjja, para. 39.

<sup>62</sup> Kundërpërgjigjja, para. 12, që i referohet Vendimit të Dytë të Apelit, para. 59, në të cilin Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se, pasi kishte miratuar pjesërisht pikën e shtatë të apelit të Shalës kundër Vendimit të Tretë për Paraburgimin, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej pika e tetë e apelit të Shalës (në lidhje me pretendimin për standardin panevojshmërisht të lartë të vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për kushtet e propozuara të lirimit).

<sup>63</sup> Shih Apeli, para. 31-33.

Ligjit, është se duhet të tregohet, nga njëra anë, se është më pak se e sigurt, por, nga ana tjetër, më shumë se thjesht e mundur, që rreziku të materializohet.<sup>64</sup>

28. Paneli vëren se në vlerësimin e tij për rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në faktorët e mëposhtëm: (i) [REDAKTUAR];<sup>65</sup> (ii) nevojën për masa mbrojtëse, e cila demonstroi një rrezik të shtuar, duke qenë se ngjarjet mbi të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme;<sup>66</sup> dhe (iii) njohjen gjithnjë e më të plotë të Shalës me provat kundër tij për shkak të ecurisë së mëtejshme të fazës paraprake.<sup>67</sup>

29. Në lidhje me mbështetjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në [REDAKTUAR] Shalës [REDAKTUAR], Paneli konstaton se Shala thjesht shpreh mospajtim me analizën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për këtë faktor dhe përsërit argumentet e pasuksesshme të cilat tashmë janë trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>68</sup> Paneli gjykon se Shala nuk ka evidentuar ndonjë gabim konkret dhe, për më tepër, se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shpjeguar qartë pse [REDAKTUAR] Shalës [REDAKTUAR] – një vlerësim ky më të cilin Paneli pajtohet.<sup>69</sup> Rrjedhimisht, dhe duke qenë se [REDAKTUAR] duhet të shqyrtohen brenda kontekstit të përgjithshëm të paraburgimit, së bashku me faktorët e tjerë të përmendur më lart,<sup>70</sup> Paneli rrëzon argumentet e Shalës në këtë aspekt.

30. Së dyti, Paneli vëren se në kundërshtim me pretendimet e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk *supozoi* se ecuria e mëtejshme e fazës së procedurës

---

<sup>64</sup> Vendimi i Parë i Apelit, para. 23 dhe referencat që përmban. Shih gjithashtu Vendimi i Parë i Apelit, para. 22, 24.

<sup>65</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 37-40.

<sup>66</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 37.

<sup>67</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 38-40.

<sup>68</sup> Shih Vendimi i Parë i Apelit, para. 34-38, 41-42; Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32-35. Shih gjithashtu Vendimi i Dytë i Apelit, poshtëshënimi 43, para. 32-33.

<sup>69</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 37-40. Shih gjithashtu Vendimi i Parë i Apelit, para. 36; Vendimi i Dytë i Apelit, para. 33.

<sup>70</sup> Shih më lart, para. 28.

paraprake rrit *vetvetiu* rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, por përkundrazi mori parasysh rrethanat specifike të kësaj çështjeje, konkretisht dorëzimin e dosjes paraprake të ZPS-së dhe nxjerrjen e pritshme të identiteteve [REDAKTUAR].<sup>71</sup> Paneli rikujton se njohja gjithnjë e më e plotë e të akuzuarit me provat e ZPS-së përmes nxjerrjes së tyre si dhe me identitetet [REDAKTUAR], mund të jetë një faktor i rëndësishëm, kur shqyrtohet bashkë me faktorë të tjerë, për të vlerësuar ekzistencën e rrezikut të pengimit të procedurave.<sup>72</sup>

31. Në çështjen aktuale, Shala nuk ka provuar se ishte e paarsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të arrinte në përfundimin se njohja gjithnjë e më e plotë me provat kundër tij, marrë së bashku me faktorë të tjerë, ndër të cilët [REDAKTUAR] Shala [REDAKTUAR], shton rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit. Si rezultat, Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka gabuar në vlerësimin e tij se rreziku i pengimit të procedurave vazhdon të ekzistojë.

32. Duke pasur parasysh që kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit dhe se çdo konstatim i bërë nga Paneli për të njëjtat argumente në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera nuk do të ndikonte në rezultatin e Vendimit të Kundërshtuar, nuk është e nevojshme që Paneli t'i trajtojë ato.

33. Së fundi, Paneli vëren se, nga njëra anë, Shala argumenton se faktorët e mësipërm, së bashku me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se asnjë prej kushteve të propozuara ose atyre shtesë nuk mund të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura, kanë një ndikim “paracaktues” në çdo vendim për rishikimin e paraburgimit. Sidoqoftë, nga ana tjetër, ai nuk evidenton ndonjë gabim konkret në konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me lirimimin me

---

<sup>71</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para 38, 40.

<sup>72</sup> Vendimi i Dytë i Apelit të *Veselit*, para. 31, që i referohet çështjes së GJPN-së, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled “Decision on the ‘Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo’”, 26 October 2012, para. 65.

kusht për të faktuar një pretendim të tillë.<sup>73</sup> Në këtë aspekt, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shqyrtuar me kujdes mundësinë e lirimit me kusht dhe ka konstatuar, duke pasur veçanërisht parasysh përgjigjen e autoriteteve belge, [REDAKTUAR],<sup>74</sup> dhe se në këtë fazë asnjë kusht nuk ishte i mjaftueshëm për të zvogëluar rrezikun që Shala të pengonte procedurat ose të kryente krime të tjera.<sup>75</sup>

34. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Shala nuk ka provuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi një standard të pazbatueshëm për lirimin me kusht. Rrjedhimisht, pika e katërt e apelit të Shalës rrëzohet.

D. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E PROPORCIONALITETIT TË PARABURGIMIT (PIKA 5)

### 1. Parashtrimet e palëve

35. Shala parashtron se, ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë pranoi se kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të fillimit të gjykimit duhet shqyrtuar së bashku me shkallën e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit për të vendosur nëse vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm”,<sup>76</sup> ai gaboi kur u mbështet në peshën e akuzave dhe në “formula klishe”.<sup>77</sup> Shala argumenton se kjo bën që kalimi i kohës të mos ketë ndikim në vlerësimin e proporcionalitetit dhe, rrjedhimisht, është në mospërputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.<sup>78</sup>

36. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me arsyetimin dhe përfundimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, pa dhënë shpjegim se pse gjithë ata faktorë në të cilët mbështetet Gjykatësi i Procedurës Paraprake përbëjnë “formula

---

<sup>73</sup> Apeli, para. 33; Kundërpërgjigjja, para. 12.

<sup>74</sup> Korrespondenca me Autoritetet Belge, f. 2.

<sup>75</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46-52.

<sup>76</sup> Apeli, para. 34, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 55. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjja, para. 13.

<sup>77</sup> Apeli, para. 36.

<sup>78</sup> Apeli, para. 35-36. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjja, para. 13-14.

klishe”.<sup>79</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shtjelluar dhe zbatuar saktë standardin përkatës, duke i kushtuar vëmendjen e duhur kalimit të kohës në kontekstin e faktorëve të tjerë sipas rrethanave të çështjes.<sup>80</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

37. Paneli i Gjykatës së Apelit thekson se Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujtoi me të drejtë rëndësinë e parimit të proporcionalitetit për përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit para gjykimit.<sup>81</sup> Arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të akuzuarit duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të secilës çështje dhe sipas veçorive të saj.<sup>82</sup> Sasia e kohës së kaluar në paraburgim në pritje të fillimit të gjykimit është një faktor që duhet të merret parasysh së bashku me rreziqet e përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, për të përcaktuar nëse, pasi janë peshuar të gjithë faktorët, vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe individit duhet të lirohet.<sup>83</sup> Gjithashtu, sa më gjatë të qëndrojë një person në paraburgim, aq më i madh është detyrimi që kanë Dhomat e Specializuara për të përligjur vazhdimin e paraburgimit.<sup>84</sup>

<sup>79</sup> Përgjigjja, para. 40.

<sup>80</sup> Përgjigjja, para. 41, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 55-57.

<sup>81</sup> Shih Vendimi i Kundërshtuar, para. 55. Paneli gjithashtu rikujton se sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake “siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes”. Shih p.sh. KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit Lidhur me Rishikimin e Paraburgimit, 5 prill 2022 (versioni konfidencial u dorëzua me 5 prill 2022) (“Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), para. 65.

<sup>82</sup> Shih p.sh. Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 65, që i referohet çështjes së GJEDNJ-së *Buzadji v. Moldova*, no. 23755/07, Judgment, 5 July 2016 (“*Buzadji v. Moldova Judgment*”), para. 90; ECtHR, *Wemhoff v. Germany*, no. 2122/64, Judgment, 27 June 1968, para. 10.

<sup>83</sup> Shih p.sh. KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Paraburgimit, 27 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2021), para. 49 dhe jurisprudenca e cituar po aty; KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021), para. 79

<sup>84</sup> Vendimi i Apelit të Gucatit, para. 73 që i referohet MPNTP-së, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Decision on Order to Show Cause, 1 October 2019, para. 11-13. Paneli rikujton se GJEDNJ-ja vlerësoi se “pas kalimit të një kohë të caktuar [fakti që vazhdon të ekzistojë arsyeja për të dyshuar se personi i arrestuar ka kryer veprë penale] nuk është më i mjaftueshëm” dhe rrjedhimisht konstatoi se ishte e nevojshme që duhet të ekzistonin edhe arsye të tjera për të përligjur vazhdimin e heqjes së lirisë. Shih KSC-BC-2020-06, IA016/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup



38. Paneli vëren se në çështjen aktuale, për të arritur në përfundimin se koha që Shala ka kaluar në paraburgim deri tani nuk është e paarsyeshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh faktorët e mëposhtëm: (i) faktin që Shala është në paraburgim që nga data 16 mars 2021; (ii) natyrën e rëndë të akuzave kundër tij, konkretisht se ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte (iii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me masa më pak kufizuese sesa paraburgimi; (v) ecurinë e mëtejshme të procedurës paraprake, përkatësisht faktin se të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë janë përfunduar ose do të përfundojnë për ta kaluar çështjen për gjykim në një të ardhme të afërt; (vi) është caktuar një datë paraprake për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues; dhe (vii) afatet kohore përkatëse janë respektuar ose vijojnë të respektohen, pavarësisht ndonjë afati të veçantë që është zgjatur ose do të zgjatet për arsye të vlefshme.<sup>85</sup>

39. Duke argumentuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në vlerësimin e proporcionalitetit, Shala mbështetet në jurisprudencën sipas së cilës GJEDNJ-ja “ka konstatuar shpesh shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës, ku gjykatat vendore kanë zgjatur paraburgimin e parashtruesit të kërkesës duke u mbështetur në thelb në peshën e akuzave dhe duke përdorur formula klishe, pa trajtuar faktorët konkretë dhe pa marrë parasysh masat alternative parandaluese.”<sup>86</sup>

---

Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Mbajtjes në Paraburgim, 25 mars 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 25 mars 2022), para. 49, i cili, ndër të tjera, i referohet çështjes së GJEDNJ-së, *Kalashnikov v. Russia*, no. 47095/99, Judgment, 15 October 2002 (“*Kalashnikov v. Russia Judgment*”), para. 114; *Buzadji v. Moldova* Judgment, para. 87; ECtHR, *Bykov v. Russia*, no. 4378/02, Judgment, 10 March 2009, para. 64; ECtHR, *Letellier v. France*, no. 12369/86, Judgment, 26 June 1991, para. 35. Ndër faktorët që duhen marrë parasysh në këtë aspekt janë, për shembull, kompleksiteti dhe karakteristikat e veçanta të hetimit, rreziku i arratisjes, rreziku i vënies nën trysni të dëshmitarëve ose i manipulimit të provave, rreziku i marrëveshjes për qëllime të paligjshme, rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i shkakimit të trazirave publike dhe nevoja për të mbrojtur të paraburgosurin. See *Kalashnikov v. Russia* Judgment, para. 114; *Buzadji v. Moldova* Judgment, para. 88.

<sup>85</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 56-57.

<sup>86</sup> Apeli, para. 35, që i referohet, ndër të tjera, çështjes së GJEDNJ-së, nr. 5826/03, *Idalov v. Russia*, Judgment, 22 May 2012, para. 147.

40. Në çështjen aktuale, Paneli konstaton se në kundërshtim me pretendimet e Shalës dhe ndryshe nga vendimet e gjykatave vendore të kritikuara nga GJEDNJ-ja,<sup>87</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vlerësuar me kujdes proporcionalitetin e vazhdimit të paraburgimit bazuar në rrethanat e kësaj çështjeje, duke marrë parasysh faktorët e renditur më sipër në paragrafin 38 të këtij vendimi, ndër të cilët kalimi i kohës.<sup>88</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shqyrtuar në mënyrën e duhur argumentet e Mbrojtjes, duke i peshuar ato kundrejt faktorëve të renditur<sup>89</sup> dhe ka shqyrtuar me kujdes masat alternative ndaj paraburgimit.<sup>90</sup> Rrjedhimisht, Paneli është i bindur se arsyetimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk është në mospërputhje me jurisprudencën e cituar të GJEDNJ-së.

41. Si rezultat, Paneli gjykon se Shala nuk ka vërtetuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në konstatimin se vazhdimi i paraburgimit të Shalës ishte proporcional. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pikën e pestë të apelit të Shalës.

## V. VENDIM

42. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** Apelin;

---

<sup>87</sup> Shih Apeli, para. 35-36, dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cituar po aty.

<sup>88</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 56-57.

<sup>89</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 53 (që i referohet Parashtrimeve të Shalës, para. 3, 5, 19, 23), 57. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi në veçanti argumentet e Shalës lidhur me: (i) kohën shtesë që ai ka kaluar në paraburgim pas Vendimit të Katërt për Paraburgimin, duke përfshirë rritjen, si rrjedhojë, të detyrimit të ZPS-së për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të Shalës; (ii) shkallën e kësaj çështjeje gjyqësore; (iii) mungesën e vizitave të rregullta nga familja dhe pasojat financiare për familjen që rrjedhin nga paraburgimi i tij; dhe (iv) faktin që procesi i nxjerrjes së materialeve nuk ka përfunduar dhe se Mbrojtjes do t'i nevojitet kohë shtesë për të analizuar materialet e nxjerra, për të kryer të gjitha hetimet e nevojshme dhe për të përgatitur dosjen paraprake.

<sup>90</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46-52; Urdhri për Parashtrime, para. 9-11; Transkripti, 14 prill 2022, f. 248-249, 296.

**URDHËRON** Shalën të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Apelit dhe Kundërpërgjigjes së tij brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim; dhe

**URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes së saj brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E martë, 19 korrik 2022

Në Hagë, Holandë.